

VENDIM
Nr. 468, datë 10.6.2020

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË FSHATIN VALIAS,
BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI
NJËSI ZBATUESE**

(Ndryshuar me VKM-në nr. 396, datë 19.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “iii” dhe “iv”, e 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë e re për zhvillim të territorit, me sipërfaqe prej 63 310 (gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e dhjetë) m², si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike;
- c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Kamzë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

(Ndryshuar harta dhe koordinatat me VKM-në nr. 396, datë 19.6.2024)

Pika	East	Nord
1	394201.408	4583079.9
2	394202.89	4583102.13
3	394218.553	4583115.68
4	394258.558	4583111.23
5	394278.878	4583121.6
6	394361.005	4583095.99
7	394379.208	4583097.05
8	394378.362	4583120.12
9	394495.625	4583170.5
10	394570.873	4583200.82
11	394598.39	4583137.85
12	394609.502	4583132.03
13	394642.575	4583068.79
14	394537.8	4583019.58
15	394456.308	4582985.71
16	394447.312	4582916.39
17	394431.966	4582876.17
18	394382.225	4582874.06
19	394361.852	4582861.62
20	394337.51	4582865.06
21	394305.495	4582871.68
22	394299.758	4582873.75
23	394334.317	4583054

Siperfaqja S=63310 m2

